



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2023:030492

Datë: 12.09.2024

Numri i dokumentit: 06152690

C-IV-14-5543

Ankuesja

B LI nga nga f.sh S K.Podujevë.

Kundër

E paditura

N.SH “FAN Barnatoret e Prishtinës”, përfaqësuar nga **Agjencia Kosovare e Privatizimit,** lagja Lakërishte- rr. “Dritan Hoxha”, nr. 55, Prishtinë.

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (Dhoma e Posaçme), gjyqtarja Hajrie Shala, me dt.09 shtator 2024, lëshon këtë:

A K T G J Y K I M

- I. **APROVOHET pjesërisht** ankesa si e bazuar dhe **NDRYSHOHEN** vendimet e Autoritetit të Likuidimit të AKP-së nr.PRN68-0122 i dt.22 qershor 2014 si dhe PRN068-0123 dt.27 qershor 2014.
- II. **OBLIGOHET** e paditura AKP, që ankuses B LI në emër të kompensimit për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës t’i paguaj shumën prej **647.90€**, dhe në emër të tri pagave të pa paguar t’i paguaj shumën prej **388.74€**.
- III. **REFUZOHET** pjesa tjetër e ankesës dhe **VËRTETOHET** vendimi i Autoritetit të Likuidimit të AKP-së nr.PRN067-0147 të dt.27 qershor 2014 si i drejtë dh i bazuar në ligj
- IV. Shumat e aprovuara si në pikën 2 të dispozitivit do të përmbushen në pajtim të prioritetit sipas kategorisë së përcaktuar të kërkesave dhe interesave në procedurën e likuidimit.
- V. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

Rrethanat faktike dhe procedurale

Me dt.25 korrik 2014, ankuesja ka dorëzuar ankesën për shqyrtimin e Vendimeve të Autoritetit të Likuidimit (tutje AL) nr. PRN68-0122 i dt.22 qershor 2014 për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës në shumë të pa caktuar, vendimit PRN068-0123 dt.27 qershor 2014 për tri paga të pa paguara në shumë prej 409.20€ si dhe vendimit nr. PRN067-0147 të dt.27 qershor 2014 lidhur me kompensimin e pagave të pa paguara për periudhën kohore 2006-2013 në shumë prej 10,639.20€ nga NSH “Barnatoret e Prishtinës” (në likuidim). Në ankesën e saj thekson se të gjithë punëtorët ishin pre e ndërprerjes së marrëdhënies së punës nga ndërmarrja dhe rrjedhimisht të gjithë kanë të drejtë në kompensim. AKP nuk ua kishte mohuar këtë, por AKP ua ka refuzuar kërkesat e tyre duke pretenduar se këto kërkesa për kompensim janë të parashkruara. Ka shtuar se si çdo punëtor tjetër i plotëson kriteret për kompensim dhe se nuk ka qenë e nevojshme që ti drejtohet gjykatës apo ndonjë autoriteti tjetër kompetent. Së bashku me ankesën ka bashkëngjitur: tri kopjet e vendimeve të kundërshtuara, tri formularët e likuidimit për parashtrimin e kërkesës, shkresë “Salary payment” 07/2001, Listë e të ardhurave personale nëntor 2004, kopja e librezës së punës.

Me anë të urdhrit të dt.29 shtator 2023, gjykata ka kërkuar nga ankuesja që të bëjë dorëzimin e njoftimit për ndërprerje të marrëdhënies së punës si dhe prova të tjera shtesë. Ankuesja 18 tetor 2023, ka bërë dorëzimin e Letër konfirmimit të dt.19.02.2020 të lëshuar nga AKP si dhe kopjen e librezës së punës.

Me dt.16 shkurt 2024, e paditura AKP parashtrori mbrojtje në të cilën pohoi se AL ka kryer një vlerësim të saktë të rrethanave faktike dhe zbatim të drejtë të dispozitave ligjore. E paditura pohoi se ankesa është e pa pranueshme pasi që konsideron se është e rëndësishme të theksohet se objekti i kësaj procedure gjyqësore është vetëm ligjshmëria. Në këtë kontekst 74.2 i Ligjit 06/L-086 parashikon që ankesat e dorëzuara në DHPGJS kundër vendimeve të AL-së duhet të bazohen në pretendimet se procesi i likuidimit nuk është kryer në përputhje me Ligjin 04/L-034 për AKP-në. Parashtruesi nuk ka treguar se cilin nen e ka shkelur të Ligjit 04/L-034 është shkelur nga AL- ja me marrjen e vendimit. Argumenti tjetër në përgjigjen e parashtruar të AKP-së është se pretendimet e parashtruesit për kompensim për paga të pa paguara si dhe tri paga të pa paguara janë të parashkruara. Në varësi të dispozitave të mësipërme kërkesa duhet të jetë parashtruar në gjykatë apo autoritet tjetër kompetent brenda 3 vjetësh nga koha kur parashtruesi ka fituar të drejtën të kërkoj kompensim. Në fund e paditura AKP propozon gjykatën që ankesa të refuzohet si e pa pranueshme dhe pa bazuar.

Arsyetimi ligjor

Ankesa aprovohet si pjesërisht e bazuar dhe ndryshohen vendimet e kundërshtuara të AL-së.

Në bazë të nenit 2.4 dhe nenit 77.1.1.1 të Ligjit Nr.06-L-086 të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në

tekstin e mëtejme Ligji për Dhomën e Posaçme), gjykata zbaton dispozitat procedurale të këtij ligji.

Në bazë të nenit 76.3 të Ligjit mbi Dhomën e Posaçme, në lidhje me nenin 398 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, gjykata vlerëson se faktet që përmban ankesa e vërtetojnë atë dhe merr këtë aktgjykim pa caktuar seancë dëgjimore.

Neni 42 pika 2 e Ligjit për Dhomën e Posaçme, parasheh se pala që pretendon një fakt apo ngjarje ka barrën e dëshmisë për të dëshmuar vërtetësinë e pretendimit të tillë, duke paraqitur parashtrësas apo duke paraqitur provat materiale (të dokumentuara, fizike dhe/ose dëshmuese), ndërsa, pika 3 parasheh se pala që pretendon një fakt apo ngjarje ka mundësinë e arsyeshme për të paraqitur apo dorëzuar provat materiale për të mbështetur një pretendim të tillë, nëse pala e tillë dështon që të paraqesë apo dorëzojë provat e tilla, atëherë vlerësohet se pala nuk ka ofruar barrën e dëshmisë lidhur me pretendimin e tillë.

Sipas nenit 7 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, palët kanë për detyrë ti paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla. Me fjalë të tjera, kushdo që thotë diçka duhet ta dëshmojë atë (ei incumbit probatio qui dicit).

Neni 55.1 i Ligjit të Punës Nr. 03/L-212 (si ligj në fuqi në kohën e nxjerrjes së vendimit) parasheh që: “I punësuar ka të drejtë në pagë, e cila përcaktohet me Kontratën e Punës, në pajtim me këtë ligj, Kontratën Kolektive, Aktin e Brendshëm të Punëdhënësit” .

Gjykata vlerëson se, për kohën kur pretendohet se është krijuar detyrimi, duhet të aplikohet parashkrimi i përgjithshëm për detyrimet civile lidhur me kërkesat periodike. Këto rregulla gjenden në Ligjin mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD) nr. 690 të datës 30 mars 1978, të njëjtat rregulla gjenden edhe në Ligjin nr. 04/L-077 për Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD) i cili ka hyrë në fuqi më 19 dhjetor 2012. Në pajtim me nenin 372, paragrafi 1 i LMD-së, parashkrimi i kërkesave periodike siç është paga, është tri (3) vjet; Ligji i ri ka mbajtur të njëjtin afat parashkrimi prej 3 vitesh (neni 353, paragrafi 1, i LMD-së). Po ashtu, Ligji i Punës nr. 03/L-212 i cili është në fuqi, nuk parasheh dispozitë të veçantë për parashkrimin në lidhje me pagesat e të ardhurave, por parasheh një afat të përgjithshëm prej 3 viteve të parashkrimit, në lidhje me kërkesat që lindin nga marrëdhënia e punës. Nga dispozitat e lartcekura, gjykata vlerëson se parashkrimi si institut i së drejtës civile në përgjithësi dhe në veçanti afati 3 vjeçar i parashkrimit për kërkesat monetare, është ruajtur në të gjitha ligjet që kanë qenë të aplikuara në atë kohë, por edhe në ligjet që tani janë në fuqi.

Prandaj, shihet se parashkrimi për tri pagat e papaguara të kërkuara në këtë lëndë, si dhe për paga të pa paguara ishte i rregulluar me LMD-në (1978), i cili ishte ligj ende në fuqi në atë kohë. Vetëm në dhjetor 2012 ligji i aplikueshëm ndryshoi, por edhe LMD-ja ka mbajtur të njëjtin afat parashkrimi prej 3 vjetësh.

Gjykata vlerëson se nuk është kontestuese në mes palëve fakti se ankuesja ishte një punëtore e NSH “Barnatoret e Prishtinës” në Prishtinë. Në këtë çështje kontestuese, ndërmjet palëve është çështja e parashkrimit të kërkesës së ankuesja për kompensim për ndërprerje të marrëdhënies së punës, kompensim për pagat e papaguara si dhe për tri paga të pa paguara. E paditura e kundërshton kërkesën e ankueses duke pretenduar se e njëjta është parashkruar, me arsyetim se ankuesja nuk ka ndërmarrë ndonjë veprim me qëllim të ndërprerjes së këtij afati. Ankuesja, bazën e kërkesës së saj e mbështet në tri kopjet e vendimeve të kundërshtuara, tri formularët e likuidimit për parashtrimin e kërkesës, shkresë “Salary payment” 07/2001, Listë e të ardhurave personale nëntor 2004, kopja e librezës së punës, letër konfirmimin si dhe kopjen e librezës së punës si dhe në pohimet e saj të parashtruara në ankesë.

Nga Lista e rrogave të mbetura borxh nëntor 2004, vërtetohet fakti se ankuesja kishte pagë në shumë prej 129.58€.

Andaj, gjykata i pranon si prova relevante dhe të bazuara listë-pagesën e muajit nëntor 2004, për të arritur në përfundim se ankuesja ka ofruar shërbime punë për NSH-në dhe se NSH i ka mbetur borxh tri pagat, po ashtu ankueses i takon edhe kompensimi për ndërprerje të marrëdhënies së punës. E paditura nuk ka dëshmuar të kundërtën dhe nuk ka dorëzuar ndonjë provë për të vërtetuar faktin se ankuesja nuk kishte ofruar shërbime pune për NSH në periudhën e lartcekur, apo se nuk i ka mbetur pagat borxh, ashtu siç përshkruhen në listën e pagave për muajin nëntor 2004 nga personat përgjegjës të NSH-së.

Me rastin e aprovimit të shumës në lartësi prej 388.74 €, gjykata është bazuar në listë pagesën e pagave të muajit nëntor 2004, e cila është e nënshkruar nga Drejtori financiar I Sh, si dhe menaxheri i barnatores, e njëjta po ashtu e mban edhe logon e NSH-së.

Neni 12.2 i Rregullores së UNMIK- ut 2001/ 27 (si ligj në fuqi në kohën e ndërprerjes së marrëdhënies së punës) thotë që: “Në rastet e largimit të shkallës së gjerë nga puna zbatohen dispozitat e mëposhtme: (dh) punonjësi nuk mund të largohet nga puna derisa punëdhënësi të mos ia ketë paguar atij një dëmshpërblim të njëkohshëm. Dëmshpërblimi duhet t’i paguhet punonjësit në datën e shkëputjes së kontratës së punës sipas shkallës së mëposhtme:

- (i) prej 2 deri në 4 vjet stazh 1 pagë mujore;
- (ii) prej 5 deri në 9 vjet stazh 2 paga mujore;
- (iii) prej 10 deri në 19 vjet stazh 3 paga mujore;
- (iv) prej 20 deri në 29 vjet stazh 4 paga mujore;
- (v) 30 vjet stazh e më tepër 5 paga mujore;

Gjykata e aprovoi shumën si në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke u bazuar në Listën e të ardhurave personale të muajit nëntor 2004, ku ankuesja pagën e kishte në shumë prej 129.58€, kurse nga letërkonfirmimi si dhe librezë e punës, vërtetohet se ankuesja kishte ofruar shërbime për NSH-në nga dt.01.02.1993 deri me dt.31.07.1998, si dhe nga dt.31.08.1998 deri me dt.31.05.2013, e që i bie se ka ofruar shërbime për 33 vite e 10 muaj. Andaj, gjykata në bazë të

dispozitive ligjore erdhi në përfundim se ankuesit i takojnë 5 paga e që i bie (5 x 129.58€=647.90€).

Gjykata ka vlerësuar edhe pretendimet e tjera dhe kundërshtimet e palës së paditur në lidhje me objektin e kontestit, por të njëjtat nuk kanë ndikuar për të vendosur ndryshe në këtë çështje.

Nisur nga kjo gjendje, gjykata vie në përfundim se ankuesja B Ll, kishte ofruar shërbime pune për NSH-në dhe se NSH-ja i kishte mbetur borxh tri paga të pa paguara dhe kështu i takon e drejta në kompensim për tri paga të pa paguara si dhe kompensim për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës, në shumën e aprovuar.

Andaj në bazë të të lartcekurave dhe në pajtim me nenet 54.1 dhe 74.4 të Ligjit për Dhomën e Posaçme u vendos si në dispozitiv të aktgjykimit.

Shpenzimet gjyqësore

Në bazë të nenit 62.5 të Ligjit për Dhomën e Posaçme secila palë do ti mbulojë shpenzimet e veta. Ankuesja e ka paguar taksën gjyqësore me dt.11 shtator 2023.

Këshillë juridike

Kundër këtij aktgjykimi mund të parashtrohet ankesë me shkrim në Kolegjin e Apelit të Dhomës së Posaçme brenda 15 ditëve nga pranimi i këtij aktgjykimi. Ankesa duhet të dorëzohet në bazë të nenit 9.6 të Ligjit për Dhomën e Posaçme.

Gj y q t a r j a
Hajrie Shala